


# Indeksi i Çmimeve të Konsumit

## Qershor 2017

**Tiranë, më 10 Korrik 2017:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Qershor 2017, arriti 102,4 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në muajin Qershor 2017 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit është 2,2 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (%)




### Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në Qershor është ndikuar kryesisht nga grupi “ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,87 pikë përqindje. Çmimet e grupit “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “pije alkoolike dhe duhan” dhe “transporti” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “argëtim e kulturë” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit “komunikimi” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje. Çmimet e grupit “veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,10 pikë përqindje. Çmimet e grupit “mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” kanë kontribuar me -0,03 pikë përqindje.

**Për publikim 10/07/2017**

**Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor**



**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Qershor 2016, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “ushqime dhe pije joalkoolike” me 5,1 %, pasuar nga grupet “mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,2 %, “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,9 %, “pije alkoolike dhe duhan” me 0,8 %, “transporti” dhe “shërbimi arsimor” me 0,7 %, “argëtim dhe kulturë” me 0,6 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 16,8 %, pasuar nga nëngrupet “zarzavate përfshirë patatet” me 12,1 %, “qumësht, djath e vezë” me 4,3 %, “peshk” me 3,7 %, “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 2,7 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 2,9 %.

**Ndryshimi mujor i indeksit është - 0,3 %.** Krahasuar me Maj 2017 ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupet “ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “argëtim dhe kulturë” me 0,7 % secili, pasuar nga grupet “veshje dhe këpucë” me 0,5 %, “transporti” me 0,4 %, etj. Rritje mujore e çmimeve vërehet në grupet “pije alkoolike dhe duhan” dhe “mallra dhe shërbime të tjera” me 0,1 % secili.

**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	06-16	07-16	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>100,2</b>	<b>100,2</b>	<b>101,1</b>	<b>101,5</b>	<b>101,2</b>	<b>101,3</b>	<b>102,2</b>	<b>103,7</b>	<b>104,3</b>	<b>104,7</b>	<b>104,0</b>	<b>102,8</b>	<b>102,4</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	100,4	100,4	102,8	103,1	102,4	101,9	104,6	108,5	110,1	110,6	109,1	106,2	105,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	101,0	101,0	100,9	100,9	101,1	100,9	101,3	101,4	101,4	101,7	101,9	101,7	101,7
3	Veshje dhe këpucë	4,0	98,3	98,1	98,1	99,9	100,3	100,6	100,9	99,9	97,6	97,7	96,0	96,4	95,8
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	100,4	100,3	100,2	100,4	100,5	101,5	100,9	101,1	101,3	101,8	101,5	101,4	101,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	100,3	100,5	100,5	100,2	99,6	100,2	100,2	100,3	100,1	99,9	99,9	99,9	99,8
6	Shëndeti	3,0	100,2	100,1	100,0	100,1	100,0	100,2	100,2	100,3	100,3	100,2	100,1	100,2	100,1
7	Transporti	6,2	98,6	99,4	99,8	99,5	99,6	99,5	99,2	99,4	98,9	99,9	100,4	99,7	99,3
8	Komunikimi	2,5	100,0	99,9	99,9	100,5	100,5	100,7	100,6	100,2	100,2	100,2	100,5	100,5	100,5
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	100,9	101,7	101,4	101,7	101,2	100,9	102,3	103,3	103,0	103,3	104,7	102,2	101,5
10	Shërbimi arsimor	2,5	100,0	100,0	100,0	99,9	100,4	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,0	100,1	100,1	100,2	100,2	100,2	100,2	100,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	100,2	100,0	100,4	103,3	103,1	103,1	103,3	103,2	103,2	103,5	103,3	103,3	103,4

**Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	06-16/06-15	07-16/07-15	08-16/08-15	09-16/09-15	10-16/10-15	11-16/11-15	12-16/12-15	01-17/01-16	02-17/02-16	03-17/03-16	04-17/04-16	05-17/05-16	06-17/06-16
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,2</b>	<b>1,9</b>	<b>2,0</b>	<b>1,8</b>	<b>1,5</b>	<b>1,9</b>	<b>2,2</b>	<b>2,8</b>	<b>2,2</b>	<b>2,1</b>	<b>1,9</b>	<b>2,0</b>	<b>2,2</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,7	4,3	4,7	3,7	3,1	3,2	4,6	5,8	3,9	3,3	3,0	3,8	5,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,4	1,7	1,4	1,4	1,6	1,5	1,3	0,9	0,6	0,5	1,0	0,8	0,8
3	Veshje dhe këpucë	-1,5	-1,3	-0,4	1,4	1,0	0,8	0,9	0,6	-0,4	-0,7	-2,3	-2,1	-2,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,2	0,0	0,0	0,1	0,5	1,5	0,9	0,4	0,6	1,1	0,9	0,9	0,9
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,9	1,0	0,8	0,8	0,3	0,7	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3	-0,4	-0,5
6	Shëndeti	0,5	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	0,2	0,2	0,2	0,2	0,1	-0,1	0,2	-0,1
7	Transporti	-3,6	-3,3	-2,2	-1,7	-1,5	-0,5	-0,8	2,8	3,2	3,8	4,3	2,6	0,7
8	Komunikimi	-1,0	-1,2	-0,1	0,5	0,5	0,7	0,6	0,2	0,2	-0,1	0,6	0,6	0,5
9	Argëtim dhe kulturë	1,6	2,8	2,4	1,7	1,0	0,8	2,3	3,1	2,8	3,2	4,5	2,0	0,6
10	Shërbimi arsimor	4,8	4,8	4,4	3,8	0,4	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,0	1,0	0,8	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2	0,2	0,1	0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,1	0,7	2,6	3,0	2,7	3,3	3,2	3,0	3,4	3,1	3,0	3,2

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	06-16	07-16	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17
	<b>Gjithsej</b>	<b>-0,6</b>	<b>0,1</b>	<b>0,9</b>	<b>0,3</b>	<b>-0,2</b>	<b>0,1</b>	<b>0,9</b>	<b>1,5</b>	<b>0,5</b>	<b>0,4</b>	<b>-0,6</b>	<b>-1,2</b>	<b>-0,3</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-1,9	0,1	2,3	0,3	-0,7	-0,5	2,7	3,7	1,5	0,5	-1,4	-2,7	-0,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,1	0,0	-0,1	0,0	0,2	-0,3	0,4	0,1	0,0	0,3	0,2	-0,2	0,1
3	Veshje dhe këpucë	-0,1	-0,3	0,0	1,8	0,4	0,3	0,3	-1,0	-2,3	0,1	-1,7	0,3	-0,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,1	-0,1	0,0	0,2	0,1	1,0	-0,6	0,2	0,2	0,5	-0,3	-0,1	0,0
5	Mobilijë, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	0,2	0,0	-0,2	-0,6	0,6	0,0	0,1	-0,1	-0,2	0,0	0,0	-0,1
6	Shëndeti	0,2	0,0	-0,2	0,1	-0,2	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,1	-0,1
7	Transporti	1,5	0,8	0,4	-0,3	0,1	-0,1	-0,3	0,2	-0,5	1,0	0,5	-0,7	-0,4
8	Komunikimi	0,2	-0,1	0,0	0,6	0,0	0,2	0,0	-0,4	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,7	0,8	-0,3	0,3	-0,5	-0,3	1,4	0,9	-0,3	0,4	1,3	-2,4	-0,7
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,5	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,0	-0,2	0,3	2,9	-0,1	-0,1	0,2	0,0	-0,1	0,3	-0,2	0,0	0,1

### SHPJEGIME METODOLOGJIKE

#### - Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Lista e mallrave dhe shërbimeve është përditësuar, në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte në vitin e kaluar.
- Lista e njësive tregtare ku mblidhen çmimet është përditësuar.

#### - Përkufizime

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)** është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin **t** llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit **(t-1)**

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.